



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 48, datë 26.03.2025

PËR

MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË LEJEN E ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:
“HOTEL ME 7 KATE MBI TOKË, ME 1 KAT NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË
RRUGËN “VAL DETI”, BASHKIA DURRËS

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Erion Keçi” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në Lejen e Zhvillimit për objektin: “Hotel me 7 kate mbi tokë, me 1 kat nëntokë”, me vendndodhje në Rrugën “Val Deti”, Bashkia Durrës, me subjekt zhvillues shoqërinë “Erion Keçi” sh.p.k, të miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 24.11.2021 të Këshillit Kombëtar të Territorit.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur Vendimit Nr. 17, datë 24.11.2021, të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e lejes zhvillimore për objektin: Hotel me 1 dhe 7 kate, me 1 kat nëntokë” me vendndodhje në Bashkinë Durrës, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Marrëveshja përkatëse për delegimin e kompetencave, bashkëlidhur Vendimit Nr. 17, datë 24.11.2021, të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e lejes zhvillimore për objektin: Hotel me 1 dhe 7 kate, me 1 kat nëntokë” me vendndodhje në Bashkinë Durrës, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi.
4. Të gjitha procedurat administrative/ligjore të parashikuara në Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, për objektin e përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, do të vijohen nga Këshilli Kombëtar i

Territorit dhe Ujit, ndërsa çertifikata e përdorimit do të lëshohet nga Sekretariati Teknik i KKTU-së.

5. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit, hyr në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
MIRELA KUMBARO (FURXHI)



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshtkruar më datë 23 / 07 / 2025